



Marrëdhëniet Shqipëri-Kosovë: Quo Vadis?

Dr. Ilir Kalemaj

Marrëdhëniet Shqipëri-Kosovë: Quo Vadis?

Dr. Ilir Kalemaj

TABLA E LENDES

Përmbledhje.....	2
Hyrje.....	4
<i>I. Rezultatet e Pritshme.....</i>	<i>8</i>
<i>II. Qëllimi i Studimit.....</i>	<i>9</i>
<i>III. Metodologjia.....</i>	<i>10</i>

KAPITULLI I

1.1 Marrëdhëniet dhe mosmarrëveshjet ndërmjet Shqipërisë dhe Kosovës në Këndvështrimin Historik.....	13
1.2 Gjetjet e fundit nga sondazhe dhe anketa të cilat matin perceptimet nga poshtë lart.....	15

KAPITULLI II

Komuniteti Ndërkombëtar dhe Zhvillimi i Kosovës.....	18
2.1 Mbështetja Politike, Ligjore, Teknike dhe Financiare e BE ndaj Kosovës.....	18
2.2 Roli i OKB në Kosovë mbas Shpalljes së Pavarësisë.....	19
2.3 Roli dhe Ndikimi i SHBA që prej Pavarësisë deri më Sot.....	20

KAPITULLI III

Tango Treshe: BE, Kosova dhe Shqipëria.....	21
3.1 Pozicioni i Shqipërisë ndaj Integritit në BE dhe Ndikimi i tij në të Ardhmen e Marrëdhënieve Shqipëri-Kosovë.....	21
3.2 Pozicioni i Kosovës ndaj Integritit në BE dhe Ndikimi në të Ardhmen e Marrëdhënieve Shqipëri-Kosovë.....	25
3.3 Gjetjet nga Fokus Grupi.....	26

KAPITULLI IV

Analiza e Marrëdhënieve Afatshkurtra, Afatmesme dhe Afatgjata ndërmjet Shqipërisë dhe Kosovës.....	29
4.1 Kosova dhe Shqipëria: Skenarët e Mundshëm.....	29
4.1.1 Skenari A.....	29
4.1.2 Skenari B.....	30
4.1.3 Skenari C.....	31
4.1.4 Skenari D.....	32
Konkluzione dhe Rekomandime.....	34
Bibliografia.....	38

Përmbledhje

Ky studim synon të eksplorojë marrëdhëniet mes Shqipërisë dhe Kosovës ashtu siç janë në të tashmen dhe trajektoren e mundshme që ato do të marrin në të ardhmen e afërt. Si pikënisje është studimi i këtyre marrëdhënieve që nga shkurti i vitit 2008 kur Kosova shpalli pavarësinë e saj dhe se si procesi i shtet-ndërtimit dhe njohjes ndërkombëtarë të Kosovës kanë ndikuar dhe kushtëzuar marrëdhëniet e saj me Shqipërinë. Elitat kryesore në të dy vendet janë përfshirë në këtë diskutim dhe që prej atëherë kanë dalë disa propozime. Nga ana tjetër, në të njëjtën kohë duket se po zhvillohet një debat tjetër që lidhet me identitetin kosovar, si një identitet i ri dhe i veçantë përkundëjt kuptimit tradicional dhe të pandarë të identitetit shqiptar, debat në të cilin janë përfshirë një pjesë e konsiderueshme e elitës politike dhe kulturore në të dy anët e kufirit.

Në këtë kuadër, stereotipat rreth ‘Shqipërisë së Madhe’ dhe bashkimit të Kosovës me Shqipërinë vazhdojnë të përsëriten si pjesë e diskursit në Ballkan, sidomos tek fqinjët Serbë, të cilët kanë shprehur frikë për zhvillime të tilla. Në këtë diskurs përfshihen edhe përpjekjet e bëra nga qeveritë e Shqipërisë dhe Kosovës, megjithëse ndikimi i tyre mbetet për t'u parë, duke filluar që nga unifikimi e kurrikulave dhe teksteve shkollore tek bashkimi i konsullatave në disa vende apo edhe tek një bashkim energjitik midis dy vendeve. Nga ana tjetër, sondazhe të realizuara nga organizata ndërkombëtare dhe organizata vendore në Shqipëri, të dhënat e të cilave janë paraqitur më poshtë, nuk tregojnë për ndonjë mbështetje popullore për ‘Shqipërinë e Madhe’, çka tregon se frikat e sipërpërmendura mbeten pa ndonjë bazë të fortë mbështetjeje.

Megjithatë, të dhënat më të fundit të cilat do të analizohen në mënyrë më të plotë më poshtë në këtë studim, dëshmojnë për një rritje të ndjenjave nacionaliste në Shqipëri përkundëjt një rënie të kësaj ndjenje në Kosovë, e cila gjithashtu ka të bëjë me mënyrën se si masat e gjera dhe

elitat e shohin të ardhmen e Marrëdhënieve Shqipëri-Kosovë. Është pikërisht qëllimi i këtij studimi që të bëjë një vlerësim të faktorëve kyç të brendshëm dhe të jashtëm që do të ndikojnë të ardhmen e marrëdhënieve mes Tiranës dhe Prishtinës dhe të bëjë parashikime për skenarët e mundshëm të marrëdhënieve dypalëshe në njëzetë deri tridhjetë vitet e ardhshëm. Këto katër skenarë janë:

A. Kufijtë e Kosovës dhe Shqipërisë gradualisht bëhen të parëndësishëm, kjo si pjesë e Bashkimit Evropian, nëse të dy vendet do të jenë integruar deri në atë fazë.

B. Shqipëria dhe Kosova bëhen pjesë e një prej propozimeve rajonale të mëposhtme (si p.sh. Bashkimi Ballkanik, Beneluksi Ballkanik, CEFTA, etj.), por vetëm një prej dy vendeve (me shumë gjasa Shqipëria) është pjesë e BE.

C. Shqipëria dhe Kosova kanë arritur një bashkim de facto përpara anëtarësimit në Bashkimin Evropian.

D. Shqipëria dhe Kosova qëndrojnë si dy shtete por pa ndonjë bashkim të projektuar të çfarëdo lloji, ku Shqipëria anëtarësohet në BE, ndërsa Kosova vazhdon procesin ende të papërfunduar të ndërtimit të shtetit.

Në këtë studim unë do të tregoj se skenari më i mundshëm që do të ndodhë në periudhën e dhjetë viteve të ardhshëm është skenari i fundit (D), ndërsa skenari më i mundshëm që me shumë gjasa do të shpaloset në dekadën në vijim është skenari B. Këtë përzgjedhje të skenarëve e mbështes mbi gjetjet e grumbulluara nëpërmjet analizës së të dhënave dytësore ekzistuese, dhe atë se cili nga skenarët ka gjasa të shpalosen në periudhën afatshkurtër dhe afatmesme e mbështes tek të dhëna nga fokus grupet, të cilat janë përdorur për të testuar hipotezat e mia.

Hyrje

Dhuna e shfaqur së fundi në stadiumin e Beogradit, ku Shqipëria ishte duke luajtur me Serbinë në ndeshje të vlefshme për kualifikim në Kampionatin Evropian, risolli edhe një herë epitetin ‘fuçi baroti’, epitet të cilin Ballkani e gëzon në mënyrë të palavdishme. Koret raciste dhe ksenofobike të tifozëve serbë të futbollit, që kulmuan me thëniet "*ubij, ubij shqiptar*" [vritini, vritini shqiptarët], u shfaqën krah për krah me fluturimin e flamurit të Shqipërisë së Madhe, të marrë si një provokim të hapur ndaj serbëve meqenëse në të ishin portretizuar si pjesë të Shqipërisë jo vetëm Kosova por edhe rajone të Serbisë jugore. Ngjarjet u përshkallëzuan me sulme verbale ndërmjet Tiranës dhe Beogradit dhe vizita e kryeministrit Rama u shty për tre javë. Për më tepër, ajo u bë e mundur vetëm pas ndërhyrjes së drejtpërdrejtë të Kancelares Gjermane Merkel e cila i telefonoi të dy udhëheqësit dhe u kërkoi atyre që të vazhdojnë me premtimin e marrë pak kohë më parë në Berlin, në të ashtuquajturën Axhenda e Berlinit për integrimin e Ballkanit Perëndimor.

Vizita e kryeministrit shqiptar në Beograd u ndoq me shumë kureshtje, pritmëri dhe vëmendje nga publiku i të dy vendeve në Serbi dhe Shqipëri, si dhe ndërmjetësuesit ndërkombëtarë që në radhë të parë bënë të mundur këtë vizitë. Kulmi i vizitës ishte konferenca për shtyp e të dy udhëheqësve, ku Rama deklaroi se "[n]e kemi dy qëndrime krejtësisht të ndryshme ndaj Kosovës, por realiteti është një dhe i pandryshueshëm", dhe duke shtuar se "Kosova e pavarur është një realitet i pamohueshëm rajonal dhe evropian, dhe ajo duhet të respektohet". Kryeministri i Serbisë u përgjigj duke thënë se "sipas kushtetutës Kosova është Serbi dhe unë jam i detyruar të them se askush nuk mund të poshtërojë Serbinë", përgjigje të cilës Rama ia ktheu se "më vjen keq por ky është realiteti që shumë e njohin: sa më shpejtë (që)

ju ta njihni atë aq më shpejt ne mund të ecim përpara".¹ Këto këmbime të nxehta lanë në hije arritjet konkrete të vizitës, të cilat ishin disa marrëveshje që rregullojnë lirinë e lëvizjes së qytetarëve të dy vendeve, shkëmbime të të rinjve, si dhe heqja e disa barrierave tregtare dhe koordinimi i patrullave policore në dogana. Gjithashtu, Rama lehtësoi frikën e Serbisë për bllokimin nga Shqipëria të Serbisë në forumet Euro-Atlantike, duke u shprehur qartë se Shqipëria nuk do të bllokojë hyrjen e Serbisë në NATO.²

Edhe para vizitës së kryeministrit Rama në luginën e Preshevës, një territor serb i banuar kryesisht nga shqiptarë etnikë, ambasadori shqiptar në Kosovë Qemal Minxhozi ndjeu nevojën për të qenë i qartë: "Shqipëria nuk ka në axhendën e saj 'Shqipërinë e Madhe', por në vend të saj ka integrimin evropian".³ Por, në të njëjtën intervistë ai shtoi se deri në fund të vitit në vazhdim do të arrihet një standard i unifikuar mes Shqipërisë dhe Kosovës lidhur me prodhimet bujqësore dhe e njëjta gjë edhe për disa çështje të tjera ndërmjet dy vendeve.⁴ Kjo tregon se si Kosova po vazhdon të jetë një çështje vendimtare dhe një mollë sherri në marrëdhëniet ndërmjet Shqipërisë dhe Serbisë, por edhe dykuptimësinë e Tiranës në marrëdhëniet e saj me Kosovën.

Kosova shpalli pavarësinë e saj nga Serbia më 17 shkurt 2008. Me gjithë kundërshtimin e fortë të Serbisë e cila ka përdorur mjete diplomatike për të bindur shtetet që të mos e njohin Kosovën, aktualisht ajo është njohur nga 106 vende të botës. Përveç kësaj, me ndërmjetësimin e BE, në prill 2013 Serbia dhe Kosova arritën një marrëveshje të rëndësishme për normalizimin e marrëdhënieve e cila parashikon shfuqizimin e institucioneve paralele dhe ngritjen e komunave të komuniteteve me shumicë serbe, të cilat do të funksionojnë në përputhje me ligjet e Kosovës.

¹ Shih për një mbulim të detajuar në shtypin ndërkombëtar, duke përfshirë edhe mediat prestigjioze si CNN, BBC, Washington Post, etj. Fjalëkëmbimi mëposhtëm është cituar nga Reuters:

² <http://www.reuters.com/article/2014/11/10/us-serbia-albania-kosovo-idUSKCN0IU16W20141110>

³ <http://www.top-channel.tv/new/lajme/artikull.php?id=287595#rel>

⁴ <http://www.gazetatema.net/web/2014/10/31/minxhozi-rama-do-te-shkoje-edhe-ne-presheve-nuk-kemi-ne-axhende-shqiperine-e-madhe/>

⁴ Po aty

Marrëdhëniet e Kosovës me Shqipërinë si ‘shteti amë’ kanë qenë një çështje vazhdimisht e spikatur, veçanërisht në dekadat që pasuan protestat e vitit 1981. Pas spastrimit etnik të Miloseviçit dhe mikpritjes nga Shqipëria të vëllezërve kosovar nën patronazhin e OKB dhe të organizatave të tjera ndërkombëtare, marrëdhëniet midis dy shteteve tashmë të barabarta kanë qenë të qëndrueshme, miqësore dhe shpesh të koordinuara për çështje të politikës së jashtme, të sigurisë, etj. Por këto fusha të bashkëpunimit të ngushtë dukshëm nuk kanë qenë të mjaftueshme për nacionalistët dhe irredentistët në të dy anët e kufijve, qofshin këta individë karizmatikë, parti politike apo grupe të lëvizjeve shoqërore. Debatet mbi identitetin kosovar, si i veçantë nga ai gjithëpërfshirës shqiptar, janë ndërmarrë kohë pas kohe, si ato të organizuara disa vite më parë nga e përjavshmja Java në Prishtinë me zëdhënës kryesor Migjen Kelmendi, por edhe figura të tjera publike të tilla si publicistit Halil Matoshi, etj. Edhe më së fundi, një debat i ngjashëm për një komb gjithëpërfshirës shqiptar kundrejt një kombi kosovar ka ndodhur në arenën publike, me përfshirjen e intelektualëve të shquar të Kosovës që shkruajnë për të përditshmet kryesore në Kosovë dhe Shqipëri. I tillë është shembulli i Shkëlzen Maliqit, një analist me zë në Kosovë dhe këshilltar aktual i kryeministrit Rama për rajonin e Ballkanit Perëndimor, i cili shkruan ndër të tjera:

“Është keqkuptimi dhe keqinterpretimi i nocionit komb, që shkakton konfuzion. Termi “komb” nënkupton të gjithë ata që jetojnë në një shtet, pa marrë parasysh se çfarë është prejardhja e tyre etnike. Në këtë kuptim, kombin kosovar do të duhej ta përbënin të gjithë ata shtetas të Kosovës, përfshirë këtu përpos shqiptarëve etnikë, edhe serbët etnikë, turqit, romët etj. Por, në përdorimin e gjatë shekullor, me termin komb janë vetëquajtuar të gjithë shqiptarët si etni dhe popull, dhe ata e konsiderojnë me të drejtë se janë të një

kombi kudo që jetojnë, në Shqipëri, Kosovë, Maqedoni, Mal të Zi, Preshevë apo në diasporat e shumta” (Maliqi 2014).

Ai zhvillon më tej logjikën e tij duke shtuar një aspekt më teorik për këtë çështje për kuptimin e lidhjes shtet-komb. Kështu ai shton:

“Sipas logjikës të atyre që thonë: pasi Kosova është një shtet i ri, duhet të ketë edhe një komb të ri kosovar; kombi shqiptar ekziston vetëm në Shqipëri, në Maqedoni shqiptarët do të duhej t’i konsideronim me kombësi maqedonase, ata në Preshevë si serbë dhe kështu me radhë... Kosovarët e të gjitha etnive ose kombësive do të pranojnë që të quhen shtetas të Kosovës, por jo edhe që serbit t’i imponohet që të ketë kombësi kosovare. Edhe shqiptari i Maqedonisë nuk kundërshton që të jetë shtetas i Maqedonisë, por jo edhe maqedonas si kombësi. Narrativi i disa intelektualëve në Kosovë projektton kombësinë, madje edhe gjuhën kosovare, që do të duhej të veçohet nga trangu shqiptar. Mendoj se kjo është tendencë absurde” (Maliqi 2014).

Nexhmedin Spahiu, një analist i njohur nga Mitrovica e qortoi drejtpërdrejt pretendimin e Maliqit duke shkruar se ‘Shkëlzen Maliqi, ashtu si ish presidentit serb Tadiç, nuk e njeh ekzistencën e një kombi kosovar’. Ai vazhdon duke shtuar se ‘kombi kosovar është përcaktuar 20 vjet më parë prej tij dhe në shkencë e drejta e autorit i shkon atij që e ka përdorur i pari një term’. Për Spahiun kombi kosovar është përbërë vetëm prej komunitetit shqiptar të Kosovës, duke përfshirë kështu serbët, romët, turqit, etj. Ai pretendon se është në të njëjtën linjë me planin e Marti Ahtisarit. Ai e mbështet argumentin e tij në faktin se Kosova ka bibliotekën e vet kombëtare, teatrin kombëtar, ekipin kombëtar të futbollit, si dhe partitë politike kombëtare të cilat ndryshe nga partitë e pakicave duhet të fitojnë më shumë se 5 për qind të votave për të kaluar pragun zgjedhor parlamentar (Spahiu 2014).

Ky diskutim më i vonshëm mbi identitetin e një kombi kosovar përfshin një dimension të brendshëm dhe të jashtëm. Ai i brendshmi ka të bëjë me Kosovën si një njësi përfshirëse apo përjashtuese përkundrejt grupeve etnike jo-shqiptare, ndërsa i jashtëmi është i lidhur direkt me marrëdhënien e supozuar që Kosova duhet të ketë me Shqipërinë. Ajo çfarë këta autorë shpalosin nëpërmjet replikave me njëri-tjetrin është pikëpamja se cila duhet të jetë e ardhmja e shtetit të ri. A duhet që ai të qëndrojë vetëm, dhe të përpiqet të zhvillojë një identitet të ri përmes mekanizmave të formimit të shtetit të cilat i paraprijnë ndërtimit të kombit? Apo duhet ta mbështesë konceptin e shtetit tek shumica shqiptare e popullsisë, dhe në këtë mënyrë të lërë të hapur mundësinë për një bashkim të mundshëm të dy shteteve shqiptare?

Sigurisht që në mes të këtyre dy pozicioneve ekstreme qëndron një element shtesë i rëndësishëm për t'u marrë në konsideratë që është procesi i integritetit në Bashkimin Evropian. Elemente të tjerë përfshijnë qëndrimin e Serbisë, ndjeshmëritë e Maqedonisë për shkak të bashkësisë së madhe shqiptare si dhe shqetësime të vendeve të tjera fqinje nëse ka një proces potencial federalizimi Shqipëri-Kosovë. Në vetvete procesi i integritetit në BE është konsideruar nga një pjesë jo e rëndësishme e spektrit politik kosovar dhe e opinionit publik si një lehtësues i bashkimit *de facto* ndërmjet dy shteteve dhe qytetarëve të tyre. Një shembull është *Vetëvendosja*, partia e tretë më e madhe në Kosovë, por e cilësuar si partia kryesore e opozitës e cila qeveris kryeqytetin Prishtinë në pushtetin lokal, e cila beson se procesi i integritetit do të mundësojë bashkimin e të dy vendeve. Kjo është një pikëpamje të cilën e ndajnë edhe homologët e tyre në Shqipëri, siç janë *Aleanca Kuqezi* dhe *Lista Natyrale*, megjithëse ndikimi i tyre politik është shumë më i vogël. Shumica në të dy anët e kufirit dhe partitë politike kryesore besojnë se nuk do të ketë ndryshim të kufijve, ose se kufijtë do të kthehen në të parëndësishme kur më në fund Shqipëria, Kosova dhe pjesa tjetër e rajonit të bëhen pjesë e familjes evropiane. Por në të dy këto

skenarë të fundit, Kosova dhe Shqipëria nuk do të përfundojnë së bashku në një federatë, konfederatë apo çfarëdo forme tjetër të dëshiruar nga nacionalistët.

I. Gjetjet e pritshme

Idetë për një federatë të përbashkët ekonomike mes Shqipërisë dhe Kosovës nuk janë të reja dhe herë pas here janë artikuluar nga udhëheqës politikë si Arbën Xhaferri apo Behgjet Pacolli, por ato nuk janë marrë seriozisht për të arritur tek përpjekjet e reja që janë ndërmarrë kohët e fundit. Ka edhe përpjekje të tjera që janë ndërmarrë ndikimi i të cilave mbetet për t'u parë, duke filluar që nga unifikimi i kurrikulave dhe teksteve shkollore tek unifikimi i konsullatave në disa vende apo tek një bashkim energjik midis dy vendeve. Në varësi të se sa të suksesshme do të jenë këto përpjekje, në 20-30 vitet e ardhshme mund të zhvillohen projeksionet e mëposhtme:

A. Kufijtë e Kosovës dhe Shqipërisë gradualisht bëhen të parëndësishëm, kjo si pjesë e Bashkimit Evropian nëse të dy do të jenë integruar deri në atë fazë.

B. Shqipëria dhe Kosova bëhen pjesë e një prej propozimeve rajonale të mëposhtme (si p.sh. Bashkimi Ballkanik, Beneluksi Ballkanik, CEFTA, etj), por vetëm një prej dy vendeve (me shumë gjasa Shqipëria) është pjesë e BE.

C. Shqipëria dhe Kosova kanë arritur një bashkim de facto përpara anëtarësimit në Bashkimin Evropian.

D. Shqipëria dhe Kosova qëndrojnë si dy shtete por pa ndonjë bashkim të projektuar të çfarëdo lloji, ku Shqipëria anëtarësohet në BE, ndërsa Kosova vazhdon procesin ende të papërfunduar të ndërtimit të shtetit.

Në këtë studim do të vlerësohen këto por edhe skenarët të tjerë të mundshëm, për të matur ndikimin dhe mjetet për arritjen e tyre. Për të ndërmarrë një studim të tillë duhen ekzaminuar me kujdes tabloja e plotë e nivelit të tregtisë para dhe pas ndërtimit të Rrugës së Kombit, anëtarësimit në CEFTA, marrëveshjeve dhe problemeve të ndryshme tregtare, anëtarësimi në organizatat ndërkombëtare (siç janë NATO, Këshilli i Evropës, etj.) dhe marrëveshjet politike, në mënyrë që rezultatet të mos jenë të bazuara tek probabiliteti por në analizë të shëndoshë. Kjo mund të shërbejë për të bërë parashikime të së ardhmes afatshkurtër dhe afatmesme, mund të ndihmojnë hartuesit e politikave, studiuesit, OJQ-të dhe mediat që të angazhohen në një debat të frytshëm në lidhje me të ardhmen e të dy vendeve.

II. Qëllimi i Studimit

Ky studim ka dy qëllime të kryesore. Së pari, ai synon të paraqesë një tablo të qartë të situatës në Shqipëri dhe Kosovë në lidhje me Marrëdhëniet e ndërsjellta që nga pavarësia e Kosovës dhe se si të dy vendet e shohin zhvillimin e marrëdhënieve të tyre përmes syve të njërit-tjetrit në periudhën afatmesme dhe afatgjatë. Së dyti, studimi zhvillon skenarët e mundshëm të këtyre marrëdhënieve nëpërmjet identifikimit të prirjeve dypalëshe, rajonale dhe më gjerë si dhe sfidat në këtë fushë. Me fjalë të tjera, ky studim vëzhgon me kujdes *status quo-në* aktuale, në mënyrë që të ofrojnë qartë shtigjet e kalimit dhe parashikime të shëndosha, duke llogaritur nga ana tjetër shanset e projektuara për realizimin e secilit prej skenarëve.

Parë nga ky këndvështrim, studimi përshkruan jo vetëm proceset e rëndësishme dhe zhvillimin e marrëdhënieve mes Shqipërisë dhe Kosovës, por gjithashtu analizon në mënyrë kritike ndërveprimet e tyre. Për secilën nga gjetjet e theksuara në tekst, unë kërkoj një

interpretim të arsyeve dhe shkaqeve për situatën e dhënë. Kështu, studimi nuk është thjesht përshkrues por ai synon të ofrojë një këndvështrim analitik dhe sy kritik në vlerësimin e ndryshimeve aktuale dhe potenciale të ndryshimit të kufijve, dhe nëse procesi do të kryhet ndonjëherë, të bashkimit në mes të Kosovës dhe Shqipërisë.

III. Metodologjia

Në këtë studim unë ndjek qasjen konstruktiviste, e cila përpiqet të kuptojë dinamikën e formësimit të ndërsjellë të identitetit kombëtar, shtet-formimit dhe ndërtimit të kufijve. Unë propozoj këtë qasje në vend të automaticitetit të supozuar dhe pikëpamjes funksionaliste ku shteti e krijon kombin ose përndryshe shkakton *efektin e përhapjes (spillover)* si rezultat i nacionalizmit, dhe procesi përfundon me harmonizimin e përsosur të kufijve të republikës dhe kombit brenda konceptit modern të shtetit-komb. Në realitet korniza mendore dhe harta vizuale janë vendimtare në të kuptuarit e formësimit të ndërsjellë të këtyre elementeve përmes ligjërimit publik. Kjo është gjithashtu e rëndësishme sepse shpesh "komunitetet etnike ndjejnë një lidhje të fortë me një të ashtuquajtur territor të caktuar 'kombëtar' dhe përdorin argumentet historikë, pseudo-historikë, apo edhe mitikë për të shpënë përpara pretendimet e tyre" (Coakley 1993: 2), kështu që kanë rëndësi sa teorike edhe praktike.

Gjithashtu, në këtë studim unë ndjek hulumtimin cilësor si një qasje që analizon marrëdhëniet Shqipëri-Kosovë në akset hapësinore dhe kohore. Kapitujt janë kronologjikë, sepse është një testim i hipotezave të mia në kohë të ndryshme, me fjalë të tjera studimi është një analizë cilësore seriale kohore. Për shkak të kësaj zgjedhje, më është nevojitur të siguroj që secili nga kapitujt të shpjegojë të njëjtat variabla qofshin kontekstuale, apo nxitëse, dhe kështu me

radhë. Prandaj dhe ndjek të njëjtën strukturë nga kapitulli në kapitull. Periudhat të cilat kam ekzaminuar janë rrethanat kritike në vijim.⁵

Unë kam përzgjedhur një studim historik dhe krahasues të marrëdhënieve të tanishme dhe të parapara ndërmjet komuniteteve shqiptare në Shqipëri dhe Kosovë, i cili lejon një analizë të thellë për të gjetur mekanizmat themelorë shkakorë të çdo ndryshimi të mundshëm të kufijve. Arsyeya e një përzgjedhje të tillë të rastit studimor justifikohet nga ndryshimet e shfaqura si në aksin kohor edhe atë hapësinor, çka lejon si kryerjen e analizës gjatësore edhe të një procesi të kujdesshëm gjurmimi me qëllim identifikimin e shkaqeve të ndryshimeve të tilla.

Është hapësinor sepse analizon ndryshimet në perceptimin virtual të kufirit në mes të dy komuniteteve shqiptare: atij që jeton brenda Shqipërisë dhe atij etnik të jashtëm që jeton në Kosovë. Ky lloj i operacionalizimi është bërë duke pasur parasysh faktin se shpesh harta e *Shqipërisë së Madhe* ka përkuar shpesh me ato institucionale, në lidhje me këtë komunitet të veçantë, i cili vetëm më vonë në shekullin e 20 u nda në shtete të ndryshme.⁶ Akset kohore analizojnë periudha të ndryshme të dallueshme që nga fundi i viteve 1990 deri në ditët e sotme për të gjetur ndryshime në perceptimet e elitës dhe të masave në të dy anët e kufirit, për të ndërtuar në këtë mënyrë një përgjigje sistematike se përse ndryshime të tilla kanë ndodhur dhe cili është projeksioni i parashikimit të kufijve në të ardhmen e afërt.

Për më tepër, përzgjedhja e rastit arsyetohet me mungesën e një analize sistematike në konceptualizimin e ndryshimeve të mundshme të kufijve dhe rëndësinë e saj aktuale në ditët e sotme. Një tjetër reflektim, janë supozimet që mund të rrjedhin për teoritë relativisht të reja mbi kufijtë territoriale dhe të identitetit nën kombinimin e këmishës së forcës, të përbëra nga faktorë

⁵ Rrethana kritike në këtë studim janë ato periudha ku janë dëshmuar mundësitë e hapjes për rikonfigurimin e hartës kombëtare dhe përshtatjes/mospërshtatjes së kësaj harte me hartën e shtetit shqiptar.

⁶ Rasti më i spikatur i kësaj është krijimi i Republikës së Maqedonisë nga Tito në vitin 1945 dhe shpëputja nga Kosova e një territori të caktuar të banuar nga popullsia shqiptare, me qëllim që ti bashkohej një shteti të ri.

sistemikë dhe aktorët specifikë, në mënyrë që të prodhojë një vlerë të shtuar për teoritë ekzistuese që shpjegojnë ndryshimet e kufijve kombëtarë.

Mënyra se si kam ndërmend të vazhdoj është që së pari të përcaktoj dhe të mat konceptet. Më tej do të testoj parashikimet e argumenteve të mia dhe analizoj të dhënat cilësore. Analizat e thelluara të ligjërimit dhe përmbajtjes janë dy nga mjetet kryesore që unë përdor për të studiuar me kujdes projeksionin e rrugëve që marrëdhëniet mes Shqipërisë dhe Kosovës mund të marrin në periudhën e afërt dhe atë afatmesme.⁷ Gjithashtu për studimin është i rëndësishëm edhe organizimi i një fokus grupi me përfaqësues të shquar të elitës së fushës së diplomacisë dhe punëve të jashtme, mjeteve të komunikimit masiv, shoqërisë civile dhe universiteteve. Kështu duke përdorur metodën e trekëndëzimit, që do të thotë të kërkuarit e shumë burimeve për të ndërtuar një pasqyrë më të saktë dhe të nuancuar të asaj se si kanë ndodhur ndryshimet, unë e përforcoj argumentin tim në vijim.⁸

⁷ Këtu unë rreshtohem në anën e akademikëve që pranojnë dobinë e analizës së ligjëratisë në studime pozitiviste, si studimi në fjalë - edhe pse pranoj dallimin në literaturë mbi këtë pikë - sepse mendoj se ajo sjell vlerë të shtuar për hulumtime e thelluara në rastet studimore në kërkime dhe përforcon gjetjet empirike në studimin në fjalë. E parë nga një perspektivë pak më të ndryshme: "studimi i ligjëratisë është më së shumti studimi i koncepteve të marrëdhënieve shkakore në mes të një grupi, apo grupesh, të aktorëve" (Lynggaard 2011). Në të dyja rastet, unë mendoj se një metodë e përdorur në mënyrë tipike më së shumti në epistemologjitë anti-themlore/ontologjike është po aq e pajtueshme me një kuadër pozitivist si ky në këtë studim.

⁸ Shih për më shumë në këtë publikimin tim të fundit: Ilir Kalemaj. 2014. *Contested Borders: Territorialization of National Identity and Shifts of "Imagined Geographies"* in Albania. Peter Lang Ltd. Oxford.

KAPITULLI I

1.1 Marrëdhëniet dhe mosmarrëveshjet ndërmjet Shqipërisë dhe Kosovës në këndvështrimin historik

Shqipërisë i ka munguar një qasje e qëndrueshme, ndaj shqiptarëve etnikë të (ish) Jugosllavisë në përgjithësi dhe ndaj shqiptarëve të Kosovës në veçanti. Kjo ka pasur disa arsye të cilat po i rreshtoj shkurtimisht më poshtë.

Para së gjithash, ka qenë konteksti gjeopolitik dhe ideologjik në periudhat në mes të dy luftërave botërore dhe asaj komuniste: kalimi nga periudha monarkike e Mbretërisë serbe-kroate-slllovene, e cila që nga viti 1928 u bë Mbretëria Jugosllave, drejt ideologjisë supra-nacionaliste komuniste. Kjo ka qenë një periudhë kur Beogradi shpesh ka pasur pushtet të konsiderueshëm mbi fatin dhe jetën e shqiptarëve etnikë jashtë kufijve të Shqipërisë por edhe mbi qeverinë e Tiranës dhe ka rezultuar në luhatje periodike në marrëdhëniet në mes të dy vendeve.

Së dyti, aleancat e ngushta në disa periudha të caktuara dhe armiqësia e hapur në të tjera kanë qenë karakteristike për marrëdhëniet Beograd-Tiranë. Marrëdhëniet kanë kaluar në faza të ndryshme dashurie dhe urrejtje gjatë qeverisë së Zogut dhe Nolit në periudhën midis dy luftërave, ku i pari kishte një marrëdhënie të ngushtë me kryeministrin Jugosllav Pashiç. Zogu dhe Pashiç kishin një marrëveshje që përfshinte shkëmbim të territoreve dhe mbështetje ushtarake dhe financiare. Ndërsa peshkop Noli kishte ndër bashkëpunëtorët e tij më të ngushtë njerëz të shquar si Hasan Prishtina, Bajram Curri apo Azem dhe Shote Galica, të cilët ishin udhëheqësit e rezistencës kundër Beogradit në Kosovë. Gjatë periudhës komuniste dallohen dy faza kryesore: e para gjatë periudhës 1944-1948 kur Tirana ishte shumë e varur nga Beogradi dhe periudha në vijim që u shoqërua nga një ftohje e konsiderueshme në mes të dy vendeve. Në

periudhën e parë Tirana refuzoi çdo bashkëpunim me 'vëllezërit' e saj jashtë kufijve të shtetit dhe mori pjesë edhe në masakra famëkeqe si ajo e Tivarit, ku u vranë qindra shqiptarë të Kosovës.’ Kushtetutën e viti 1974, që Tito e solli si një mekanizëm për të frenuar pushtetin e serbëve brenda Byrosë Politike dhe strukturave shtetërore, dhe shkallën e lirisë relative që shqiptarët e Kosovës përfituan prej saj, Tirana i pa si një dritare mundësie për të ndërhyrë në emër të tyre dhe për të filluar të përdorë një ndikimin të drejtpërdrejtë atje. Në periudhën post-komuniste, ishte ish-kreu i atëhershëm i opozitës Sali Berisha i cili për herë të parë mbështeti bashkimin e të gjithë shqiptarëve në një shtet të vetëm, por kjo gjë mbeti thjesht një retorikë. Pasi u zgjodh President ai u tërhoq nga deklaratat e mëparshme dhe në vitin 1994 e quajti çështjen e Kosovës një problem të brendshëm të ish-Jugosllavisë, dhe po ashtu pasuesi i tij socialisti Fatos Nano, i cili në një takim me Millosheviçin në Greqi e quajti Kosovën një çështje të brendshme të drejtave të njeriut për Serbinë.

Së treti, në të gjitha periudhat e sipërpërmendura Shqipëria ka qenë gjithmonë më e dobët politikisht dhe ushtarakisht, diplomatikisht e izoluar dhe në disavantazh ekonomik, në krahasim edhe me Jugosllavinë edhe me Serbinë, dhe kjo është reflektuar në qëndrimin e Tiranës ndaj 'vëllezërve' të saj shqiptarë jashtë kufijve shtetërorë.

Së katërti, mungesa e një mendimi të konsoliduar politik dhe axhende diplomatike ka bërë që Tirana të jetë përgjithësisht reaguese dhe jo proaktive në marrëdhëniet e saj me Beogradin, ndërkohë që shteti fqinj ka pasur qëndrime të mirë-strukturuara si *Nacertanija* e Garashanin, apo ‘Dëbimi i shqiptareve’ i Çubriloviç i vitit 1937, apo dhe Memorandumi 1986 e Cosiç dhe të tjerëve, të cilat fatkeqësisht më vonë u kthyen në politika zyrtare diskriminuese kundër shqiptarëve.

Ndryshe nga fqinjët e saj, në fazat fillestare të ndërtimit të kombit Shqipëria pati vështirësi në lidhjen e natyrës së saj multi fetare dhe ndarjeve të përhapura shoqërore me zhvillimin e identitetit të saj kombëtar. Vendet e tjera të Ballkanit, jo vetëm që e patën filluar këtë proces shumë më herët, por përveç kësaj patën një simbiozë të lartë në mes të një feje dominuese dhe identitetit të sapo zhvilluar kombëtar, ku feja shpesh ka shërbyer si gur themeli për këtë të fundit. Siç e ka përmbledhur Nicola Pedrazzi më së fundi: "Shqipëria nuk dallon për ndonjë konflikt të dukshëm fetar; e megjithatë, mbetet fakt se, siç ndodh në fusha të tjera të enigmës së ndërlikuar të Ballkanit, edhe në Shqipëri - dhe veçanërisht për shqiptarët etnikë që jetojnë jashtë kufijve të shtetit shqiptar - përkatësia fetare është veçanërisht e lidhur me çështjen e identitetit dhe ka, për pasojë, edhe një dimension politik "(Pedrazzi 2014).

Marrëdhënia historike në mes të Shqipërisë dhe Kosovës, dhe në veçanti trajektoret e ndryshme që të dy vendet kanë marrë si rezultat i presioneve gjeopolitike dhe zhvillimeve të brendshme, janë të rëndësishme në të kuptuarit tonë të së tashmes dhe parashikimit të së ardhmes.

1.2 Gjetjet e fundit nga sondazhe dhe anketa të cilat matin perceptimet nga poshtë lart

Një anketë e kryer nga Gallup në bashkëpunim me Fondin Evropian për Ballkanin në vitin 2010 tregoi se 62 për qind e të anketuarve në Shqipëri dhe 81 për qind në Kosovë mbështesin formimin e *Shqipërisë së Madhe*.⁹ Shumica dërmuese e të anketuarve, më shumë se 95 për qind në të dy vendet, ka pohuar se nëse "*Shqipëria e Madhe*" krijohet ajo duhet të përfshijë Shqipërinë, Kosovën dhe një pjesë të Maqedonisë. Mbështetja për bashkimin vetëm të Shqipërisë dhe Kosovës është shumë më e ulët. Vetëm 33,7 për qind e të anketuarve në Shqipëri, 29,2 për

⁹ Shih http://www.balkan-monitor.eu/files/Gallup_Balkan_Monitor-Focus_On_Kosovo_Independence.pdf

qind në Kosovë dhe 7,2 për qind në Maqedoni miratojnë këtë lloj zgjidhje. Këto të dhëna të reja shërbejnë si një dëshmi e ndryshimeve të vëna re dhe të analizuara në këtë studim, si edhe tregues empirike që (duhet të) informojnë politikën dhe merren në konsideratë nga organizatat ndërkombëtare, strukturat e BE-së dhe palëve të treta të interesuara.

Ndryshe nga të dhënat e sondazhit të Gallup, një studim i kryer nga Instituti Shqiptar për Marrëdhënie Ndërkombëtare (AIIS) 2010 zbulon një pamje krejtësisht të ndryshme. Nga sondazhi në Shqipëri, 37 për qind e të intervistuarve mendojnë se bashkimi i Shqipërisë me Kosovën nuk është as pozitiv e as negativ, 35 për qind mendojnë se është negativ dhe vetëm 9 për qind e mendojnë atë si pozitiv. Shumica (35 për qind) mendojnë se mundësia e bashkimit Shqipëri-Kosovë është e vogël, 18 për qind e mendojnë atë në terma mesatarë dhe vetëm 9 për qind mendojnë se bashkimi është i mundur. Siç mund të shihet, ka një korrelacion ndërmjet numrave të atyre që mendojnë se bashkimi është i dëshiruar dhe gjithashtu i mundur, ndërsa kjo është e vogël për kategoritë e tjera të mundësive që diçka e tillë do të ndodhë ndonjëherë. Sondazhi vazhdon duke theksuar një gjetje tjetër empirike se nëse do të ndodhte që të organizohej votim për bashkimin e Shqipërisë me Kosovën dikur në të ardhmen e afërt, atëherë 39 për qind e njerëzve që u intervistuan do të votonin në favor të bashkimit, 23 për qind kundër, 21 për qind do të abstenonin, dhe 18 për qind nuk do të merrnin pjesë. Këto të dhëna na japin një kuptim të perceptimit të kombit dhe të kufijve të tij mendorë nga poshtë. Si imagjinohet kombi, cilat janë shanset e ndryshimit të kufijve dhe bashkimit të mundshëm dhe sa është kjo e dëshiruar nga ana e shqiptarëve në të dy anët e kufirit? Siç mund të përmbledhet nga të dhënat e mësipërme, përafërsisht e njëjta përqindje e njerëzve (rreth 35-39 për qind) beson se bashkimi nuk është i mundur por që nga ana tjetër do të kishin votuar për bashkim nëse do të mundësohej një referendum.

Në Kosovë kultura popullore ka mbetur kryesisht ekspansioniste në dy dekadat e fundit, çka e ka kufizuar elitën politike në tejkalimin me nacionalizmin dhe kryesisht kanë qenë partitë e opozitës të cilat zakonisht kanë qenë më shumë në favor të ndonjë skeme bashkimi/ekspansioniste, dhe ato në qeveri kanë qenë kryesisht më të përmbajtura si rezultat i detyrimeve të jashtme. Ndërsa në Shqipëri ka ndodhur e kundërta pasi që është dëshmuar se përplasjet e elitës dhe ndryshimet politike kanë ndikuar më shumë tek kultura popullore në nivelet bazë. Kohët e fundit duket se një tejkalim etnik ka filluar të ketë ndikim në Shqipëri, me më shumë se tre parti të reja nacionaliste që morën pjesë në zgjedhjet parlamentare të 2013.¹⁰

Duke iu referuar sondazheve dhe anketave që matin ndryshimet e perceptimeve të popullsisë shqiptare në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoni, është me interes të theksohet se në përgjithësi në nivelin e elitës në Kosovë shfaqen dy rryma të ndryshme. Ajo dominuese, e përfaqësuar kryesisht nga forcat politike që përbëjnë shumicën, është e pozicionuar në mënyrë të vendosur në ruajtjen e hartës ekzistuese e cila garanton një Kosovë plotësisht sovranë që me Shqipërinë ka vetëm lidhje diplomatike. Kjo bazohet në dy faktorë parësorë. I pari është presioni i komunitetit ndërkombëtar, i cili i kundërvihet me ngulm çdo ndryshimi të kufijve, dhe i dyti është vëmendja e politikanëve që qeverisin të cilët rrezikojë të humbasin pushtetin (ekzistues) me çdo skemë të mundshme të bashkimit. Megjithatë, partia kryesore e opozitës *Vetëvendosja*,¹¹ ka si qëllim parësor bashkimin e Kosovës me Shqipërinë, duke përfshirë edhe pjesën veriore të Mitrovicës, dhe ka bërë thirrje për një referendum për realizimin e saj. Aktualisht, ka disa zhvillime të reja që

¹⁰ Këto parti të reja ishin të PDIU, një parti baza kryesore elektorale e së cilës janë shqiptarët çamë të cilët pretendojnë pasuritë e shpronësuar prej tyre nga Greqia pas shkëmbimit të popullsisë dhe të deportimit pas Luftës së Dytë Botërore, *Lista Natyrore* e Koço Danajt, i cili aspiron bashkimin e trojeve shqipfolëse në ish-Jugosllavi dhe *Aleanca Kuq e Zi*, e pozicionuar në mënyrë të qartë si irredentiste.

¹¹ Partia e tretë më e madhe e përfaqësuar në parlament.

janë duke ndodhur në politikën kosovare, ku një grup deputetësh kanë kërkuar realizimin e një bashkimi të tillë.¹²

Me ndryshimet në qeverinë e Tiranës pas zgjedhjeve të vitit 2013, duket se ka një përpjekje të rifreskuar për të forcuar bashkëpunimin në mes të Shqipërisë dhe Kosovës në disa nivele. Për shembull, në një turne në Gjakovë dhe Pejë, kryeministri Rama dha garanci për heqjen e tatimit të dyfishtë të vlerës së shtuar për librat, gazetat dhe revistat. Gjithashtu ka pasur një diskutim për të eliminuar tatimin e dyfishtë për produktet e çelikut dhe një vlerësim të përbashkët të procedurave doganore, duke forcuar kështu integrimin ekonomik dhe kulturor, si një formë simbolike të bashkimit *de facto*.

Hapa të tjerë të ndërmarra nga qeveria Rama përfshijnë heqjen e disa barrierave kufitare mes dy vendeve. Një nga këto është heqja e barrierave të punësimit për shqiptarët e Kosovës dhe Luginës së Preshevës, të cilët tani mund të punojnë në Shqipëri pa ndonjë pengesë. Kjo i vendos shqiptarët nga Kosova dhe Serbia Jugore në një kategori tërësisht të ndryshme nga çdo punonjës i huaj në Shqipëri që ka nevojë të ketë leje pune dhe rezidence për të punuar në vend. Ministri i Mirëqenies dhe Rinisë kohët e fundit deklaroi se: "ne e liberalizuar tregun e punës me Kosovën. Tani e tutje Shqiptarët nga Kosova nuk kanë nevojë të aplikojnë për certifikata të punës apo lejeve të punës. Çdo shtetas nga Kosova dhe Lugina e Preshevës mund të aplikojë për punë në Shqipëri". Sipas tij, ndryshe nga qeveria e mëparshme, "ne nuk i konsiderojmë si të huaj shqiptarët e të Luginës së Preshevës dhe në këtë mënyrë çdo qytetar që vjen prej andej mund të punojnë lirisht në Shqipëri". Ndërsa kryeministri Rama ka premtuar për heqjen e barrierave në mes të dy vendeve për të krijuar një treg të përbashkët, bashkim të përbashkët doganor,

¹² Një grup prej 12 deputetësh që përfaqësojnë katër parti parlamentare i dërguan parlamentit një petition me kërkesën për bashkimin me Shqipërinë, megjithëse dështuan në mbledhjen e firmave nga kolegë të tjerë. Qëllimi i iniciatorëve në fazën e parë ishte që të tërhiqnin vëmendjen e bashkësisë ndërkombëtare dhe për ti dhënë fund negociatave me Beogradin. Shih për detaje <http://www.alsat-m.tv/index.php/lajme/rajoni/116664.html>

certifikim të përbashkët sanitar dhe një Këshill Kombëtar Ekonomik për Shqipërinë dhe Kosovën.¹³

Ideja është që të zgjerohen më tej fushat e bashkëpunimit mes Shqipërisë dhe Kosovës, vende të cilat tashmë prej një kohe kanë zhvilluar një partneritet strategjik. Se si të lëvizet përtej kësaj drejt rezultateve më të prekshme të cilat mund të shpien në thellimin e mëtejshëm të marrëdhënieve dypalëshe, por pa rrezikuar stabilitetin rajonal dhe pa provokuar shqetësime gjeopolitike nga Serbia dhe vendet e tjera fqinje, është një sfidë në vetvete. Marrëdhëniet Shqipëri-Kosovë duhet të shihen përmes perspektivës së vendeve të tjera të rajonit si dhe marrëdhënieve të brendshme që Shqipëria ka ndërtuar ose ka në plan të ndërtojë në të ardhmen e afërt.

E parë nga ky këndvështrim, Artur Zheji, drejtor i të përditshmes “Mapo” dhe kontribuues në të, argumenton se Shqipëria ka lidhje shumë të ngushta me disa prej vendeve fqinje. Për shembull ai përmend Maqedoninë, ku siç shprehet ai "Shqipëria është aksioner në 35 për qind " të territorit, duke iu referuar sigurisht përqindjes që shqiptarët pretendojnë të kenë atje. Ai vazhdon duke shtuar se e njëjta gjë mund të jetë edhe më e vërtetë për Kosovën që është "pjesë e vërtetë dhe konceptuale e tokës së njëjtë [shqiptare], me Malin e Zi ku [Shqipëria] ka tokën e popullin e vet, me Greqinë, me të cilën shpesh është keqkuptuar bazuar në një konflikt të vazhdueshëm përgjatë një shekulli, me Serbinë e cila vetëm kohët e fundit bëri një luftë epike...." (Zheji 2014). Ai vazhdon duke theksuar se, me gjithë këto avantazhe 'të natyrshme' krahasuese, Shqipëria kurrë nuk e ka përdorur konfliktin për të arritur qëllimet, edhe pse, ashtu siç thekson Zheji, kjo më shumë për shkak se elitat shqiptare kanë preferuar korrupsionin dhe rehatinë në vend të aventurave gjeopolitike. Ai përfundon duke shkruar se ne nuk mund ta marrim të

kaluarën si të mirëqenë "sepse kapaciteti shqiptar për ndërveprim mund të kthehet shpejt në destabilizues. Kështu që ajo duhet të integrohet" (Zheji 2014).

Një tjetër analist nga Shqipëria, Afrim Krasniqi vë në pah se sa demagogjike është gjuha e elitës politike në Kosovë dhe Shqipëri, kur ata flasin në të njëjtën kohë për bashkim shpirtëror dhe kulturor, perspektivë ekonomike të përbashkët dhe procese plotësuese në çështje të tjera, ndërkohë që në praktikë realiteti është krejtësisht i ndryshëm. Për shembull në fushën e medias, Krasniqi shkruan: "secila palë vepron me mënyrat dhe mjetet e tjetrit, duke transmetuar lajmet nga vendi tjetër pa verifikimet e duhura dhe gjuha përçmuese e Prishtinës transmetohet në Tiranë dhe anasjelltas" (Krasniqi 2014). Gjithashtu, siç nënvizon autori, gazetat, revistat, librat, etj, të Shqipërisë nuk arrijnë në Kosovën dhe e njëjta gjë ndodh për ato të Kosovës, ku tregu shqiptar duket i mbyllur. Edhe ndikimi politik është shumë i kufizuar jo vetëm në drejtimin Prishtinë-Tiranë por edhe në atë Tiranë-Prishtinë, duke pasur parasysh rolin e supozuar të Shqipërisë si vendi "amëtar".

Kështu, përzgjedhja e Tiranës si epiqendra e kombit shqiptar dhe rëndësia e saj politike, kulturore dhe socio-ekonomike, duket se është kryesisht tek emri por jo faktikisht. Edhe pse në çdo kohë mund të gjenden politikanë të ndryshëm në të dy vendet të cilët përpiqen të instrumentalizojnë "Çështjet Kombëtare" për përfitime të politikës ditore, ajo që është e rëndësishme është vlerësimi se sa këto ligjërata hyjnë në veshin e publikut. Problemet janë të njëjta në të dy vendet, pavarësisht zhurmës së madhe, por në disa raste ka ndarje të mëdha publike, si në rastin e debatit Kadare-Qosja, ku figura të mëdha publike u bashkuan rreth dy mendimtarëve, edhe pse jo domosdoshmërisht sipas vijave të përkatëse shtetërore. Me fjalë të tjera, nuk është se kosovarët automatikisht mbështetën Qosen dhe shqiptarët e Shqipërisë shkrimtarin e tyre më të shquar, zotin Kadare. Në përgjithësi mbështetja për Kadaresë ishte më e

madhe në të dy anët e kufirit, dhe kjo jo vetëm për shkak të statusit të tij publik dhe intelektual por edhe për shkak se teza e tij pro-perëndimore ka gjetur më shumë jehonë tek opinioni publik i të dy vendeve.

KAPITULLI II

Komuniteti Ndërkombëtar dhe Zhvillimi i Kosovës

2.1 Mbështetja Politike, Ligjore, Teknike dhe Financiare e BE ndaj Kosovës

Bashkimi Evropian ka pasur ndikim të veçantë në ngritjen e ritmit në procesin e normalizimit të Kosovës. Ajo e ka bërë këtë përmes mekanizmave të saj të zakonshme të "shkopit dhe karotës", ose thënë ndryshe përmes një pakete stimulesh dhe kushtëzimesh që kanë synuar integrimin e Kosovës por duke siguruar ndërkohë që reformat të kryhen. BE-ja ka në dorë një sërë mekanizmash për të bërë këtë. Para së gjithash, përmes lidershit të ish shefes së politikës së jashtme baroneshës Ashton BE u përpoq të thyejë akullin në marrëdhëniet mes Beogradit dhe Prishtinës duke krijuar mundësinë që Daçiç (ish kryeministri serb) dhe Thaçi të ulen për të diskutuar dhe rënë dakord për një sërë çështjesh, duke filluar nga arkivat tek siguria, nga juridiksioni ekstra-territorial i enklavave serbe dhe kulteve fetare në Kosovë tek mbrojtja e të drejtave të minoriteteve. Negociatat dhe marrëveshjet kanë krijuar rrugën drejt një paqe të qëndrueshme në rajon dhe për procesin e integritetit të të gjithë rajonit, proces i cili mund të hapë rrugën edhe për Kosovën që së pari të njihet nga vendet e tjera evropiane që nuk e kanë bërë akoma deri më sot dhe më vonë aspirojnë për tu integruar në BE.

Lidhur me pikën e fundit, edhe pse deri në këtë moment pesë shtete evropiane (Greqia, Sllovakia, Rumania, Spanja dhe Qipro) nuk e kanë njohur ende zyrtarisht Kosovën, procesi i

dyfishtë i nisur së bashku me Serbinë nën tutelën e Bashkimit Evropian është një shenjë e mirë edhe për procesin e njohjes. Për më tepër, misioni i BE në Kosovë EULEX, ka luajtur një rol vendimtar për konsolidimin e sistemit të saj sigurisë dhe drejtësisë, pavarësisht dyshimeve për korrupsion të kohëve të fundit, të cilat a shpunë Përfaqësuesin e Lartë për Punë të Jashtme dhe Politika të Sigurisë të BE Federica Mogherini të shpallë dërgimin e "një eksperti të pavarur për të hetuar dyshimet për korrupsion në misionin për sundimin e ligjit të Bashkimit Evropian"¹⁴

2.2 Roli i OKB në Kosovë mbas shpalljes së pavarësisë

Roli Kombeve të Bashkuara në Kosovë pas periudhës së pavarësisë ka qenë gjithashtu i rëndësishëm në lidhje me krijimin e një klime të sigurisë, veçanërisht në veri të vendit (Mitrovica Veriore), ku autoriteti i qeverisë së Kosovës ka munguar, edhe pse kryesisht jo për të saj faj. UNMIK ka qenë misioni i OKB në Kosovë nga viti 1999 pas krijimit me rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit. Siç përmendet në mënyrë të qartë në faqen zyrtare të misionit, "objektivi i Misionit ka qenë promovimi i sigurisë, stabilitetit dhe respektimit të të drejtave të njeriut në Kosovë përmes angazhimit me të gjitha komunitetet në Kosovë, me udhëheqjen e Prishtinës dhe Beogradit, dhe të aktorëve rajonalë dhe ndërkombëtarë, përfshirë Misionin e Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë (EULEX), Organizatën e Traktatit të Atlantikut të Veriut (NATO) dhe Organizatën për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE). Ndërkohë, KFOR ka qëndruar në terren për të garantuar praninë e nevojshme të sigurisë në Kosovë".¹⁵

Roli UNMIK ka pasur shumë mbivendosje me misionet e tjera ndërkombëtare në Kosovë, kryesisht me EULEX dhe KFOR, por edhe me OSBE dhe ambasada të ndryshme, veçanërisht

¹⁴ <http://inserbia.info/today/2014/11/mogherini-independent-probe-for-eulex/>

¹⁵ <http://www.un.org/en/peacekeeping/missions/unmik/mandate.shtml>

me Ambasadën e SHBA e cila ka rol dhe peshë të rëndësishme. Kohët e fundit, roli dhe ndikimi i UNMIK janë rrudhur në një shkallë të konsiderueshme që nga koha e pikut të vet kur Sekretari i Përgjithshëm i OKB Ban Ki Moon propozoi planin e tij të (pa)famshëm prej gjashtë pikash.¹⁶ Plani u kundërshtua pothuajse në unison nga elita politike kosovare, një kundërshtim që u prit në mënyrë të paqartë në Tiranë sepse ish Ministri i Jashtëm Besnik Mustafai ishte në fakt në favor të një klauzole për "pavarësi e kufizuar" për Kosovën. Kjo përputhej me planin e Ban Ki Moon që ishte veçanërisht i ndjeshëm në rekomandimet e tij lidhur me kufijtë dhe trashëgiminë serbe.¹⁷

2.3 Roli i SHBA dhe ndikimi i tyre që prej pavarësisë deri më sot

SHBA ka qenë një aktor kryesor që nga fillimi i konfliktit në Kosovë kur mori rolin udhëheqës për mobilizimin e NATO dhe bombardimin e objekteve ushtarake serbe në një fushatë shtatëdhjetë e dy ditore, pasi Millosheviçi nuk e ndaloi procesin e spastrimit etnik që rezultoi në humbjen e jetëve të mijëra shqiptarëve të Kosovës ndërsa të tjerë u dëbuan me forcë nga shtëpitë dhe pronat e tyre. Natyrshëm qeveria e SHBA nuk ishte aktori i vetëm me ndikim të madh në këtë proces. Britania e Madhe luajti një rol po aq të rëndësishëm, nën udhëheqjen karizmatike të Tony Blair i cili me formulimin e konceptit të ri dhe revolucionarizues të "ndërhyrjes humanitare" i shtoi vlera të mëdha operacionit që bëri të mundur çlirimin e Kosovës.

Qeveria e Shteteve të Bashkuara dhe përfaqësuesit e saj në Prishtinë, me mprehtësi të madhe në çështjet e brendshme politike, kanë qenë një faktor i rëndësishëm që ka ndikuar në procesin e ndërtimit të shtetit në Kosovë.¹⁸ SHBA kanë pasur të njëjtin ndikim edhe në Shqipëri, Maqedoni

¹⁶ <http://www.kosovocompromise.com/cms/item/topic/en.html?view=story&id=1571>

¹⁷ Po aty

¹⁸ Shembujt janë të ndryshëm por mund të përmendim shkurtimisht këtu rolin e luajtur nga ambasadori amerikan në arritjen e marrëveshjes për të zgjedhur Ahtifete Jahjagën si President, pas vendimit të Gjykatës së Lartë që shpalli

dhe në vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor, edhe pse në një shkallë më të vogël. Shpesh, ky ndikim është i një shkalle më të madhe se ai i misionëve të BE, megjithëse në rastin e Kosovës ndoshta kanë të njëjtën peshë por në plane të ndryshme.

KAPITULLI III

3.1 Pozicioni i Shqipërisë ndaj integritetit në BE dhe ndikimi i tij në të ardhmen e Marrëdhënieve Shqipëri-Kosovë

Në rrugën e saj drejt integritetit evropian Shqipëria është shumë më përpara se sa shteti i ri i Kosovës. Pas ngadalësisë së madhe, që vijoi prej ngjarjeve të dhunshme të viti 1997, Shqipërisë iu desh ti bashkohej ish-republikave jugosllave në negociatat e Stabilizim Asociimit me Bashkimin Europian, duke mundur që më në fund të nënshkruajë marrëveshjen e saj të Stabilizim Asociimit (MSA) në 2002 dhe më tej të vijonte përpara me reformat. Për fat të keq Shqipërisë iu desh të priste për një periudhë konsiderueshëm më të gjatë se sa fqinjët e saj Kroacia dhe Maqedonia, të cilat nënshkruan statusin e tyre të kandidatit qysh në vitin 2004, dhe madje Kroacia që e suksesshme me pranimin e plotë në BE në qershor të vitit 2013.

Për më tepër, Shqipëria u parakalua edhe nga shteti i ri i Malit të Zi, që u bë i pavarur vetëm në vitin 2006, i cili nënshkroi statusin e kandidatit me BE në vitin 2010. Më vonë në 29 qershor 2012 Malit i Zi hapi dhe negociatat për anëtarësim të plotë. Shqipëria u parakalua edhe nga Serbia e cila në 12 tetor 2011 u rekomandua për të marrë statusin e kandidatit zyrtar për në BE,

pavlefshmërinë e procesit që kishte zgjedhur Behgjet Pacollin në atë post. Një tjetër dëshmi e pranisë së fortë amerikane është baza ushtarake e Bondsteel, më e madhja në Ballkan dhe prononcimet e ambasadorëve të ndryshëm amerikanë mbi punët e brendshme politike të Kosovës. Rasti i fundit ishte i ambasadorit aktual, Tracey Ann Jacobson, e cila iu drejtua elitës politike kosovare duke përdorur një shprehje të qartë shqipe "mos e dhini punën", shprehje e cila të nesërmen mori faqet e para në gazetën e përditshme në Shqipëri dhe Kosovë. Shih për më shumë detaje: <http://botasot.info/lajme/339598/ambasadorja-e-shba-ne-kosove-u-drejtohet-shqip-politikaneve-mos-e-dhini-punen-video/>

pavarësisht se MSA e kishte nënshkruar në vitin 2007, pesë vjet pas Shqipërisë. Serbia çeli negociatat për anëtarësim të plotë në Bashkimin Evropian në janar të vitit 2014.

Avancimi i konsiderueshëm i Shqipërisë në rrugën e saj të antarësimit në BE e bën atë të përmbahet rregullave dhe rregulloreve të cilat përfshijnë standarde të caktuara që nuk mund të neglizhohen në emër të miqësisë së mirë me Kosovën. Një nga këto ka të bëjë me *acquis communautaire* dhe ligjet e ndryshme dhe direktivat e BE që Shqipëria duhet ti përmbahet. Shembulli i fundit për këtë ishte importi i miellit nga Kosova, i cili nuk ishte tërësisht në përputhje me kriteret e BE, dhe përveç kësaj nivelet ushqyese të tij ishin poshtë kërkesave të standardeve të BE.¹⁹ Kjo pasoi luftëra të tjera tregtare ndërmjet të dy vendeve,²⁰ të cilat pavarësisht motiveve ose arsyeve të vërteta janë justifikuar me normat e kërkuara nga BE, veçanërisht nga Shqipëria, e cila është hapa më përpara se sa Kosovës në procesin e integritimit.

3.2 Pozicioni i Kosovës ndaj integritimit në BE dhe ndikimi i tij në të ardhmen e Marrëdhënieve Shqipëri-Kosovë

Kosova ka një sërë pengesash në rrugën e saj të vështirë për tu bërë anëtare e plotë e Bashkimit Evropian. Një nga këto është fakti se është vend i ri i pavarur. Kosova e shpalli pavarësinë e saj vetëm në shkurt të vitit 2008. Për t'i komplikuar më tej gjërat ajo është njohur vetëm nga pak më shumë se gjysma e vendeve të botës,²¹ kështu që njohja e saj nuk është e ende e pranuar botërisht, dhe ajo çfarë ka më shumë rëndësi për diskutimin këtu, atë ende nuk e kanë

¹⁹ <http://www.gazetaexpress.com/lajme/panariti-ska-barriera-per-miellin-kosovar-qe-ploteson-standardet-48693/>

²⁰ Luftëra të tilla tregtare përfshijnë por nuk kufizohen vetëm me tregtimin e patateve, mjaltit, çimentos dhe qumështit. Për më tepër detaje shih: <http://www.lajmeonline.net/en/commercial-returns-kosovo-war-shqiperi/>

²¹ Në krahasim Palestinën, e cila është njohur nga rreth 135 vende dhe ende është larg së qenit e pranuar në mënyrë legjitime në organizata ndërkombëtare apo vende të tjera dhe pavarësia e saj kundërshtuan ashpër jo vetëm nga Izraeli, por edhe SHBA-të dhe disa vende të mëdha evropiane.

njohur si shtet sovran pesë shtete anëtare të BE. Këto janë Spanja, Greqia, Sllovakia, Rumania dhe Qiproja dhe arsyet e tyre janë të ndryshme dhe po kështu është i ndryshëm edhe niveli i tyre i bashkëpunimit me Kosovën. Disa nga këto vende, si Greqia kanë hapur zyrat diplomatike në Prishtinë, por vende të tjera si Qipro janë të patundura në kundërshtimin e tyre për të njohur Kosovën, edhe nëse Serbia do të bëjë këtë, sipas deklaratës nga zyrtarë të lartë të politikës së jashtme të vendit.

Kjo e vendos Kosovën në një situatë të pasigurt, por valët e njohjes e kanë bërë qartazi Kosovën një rast të shquar dhe të dallueshëm, duke i shtuar kështu legjitimitet shkëputjes së saj dhe shpalljes së pavarësisë. Kështu Kosova është një rast *sui generis*, që nuk lidhet drejtpërdrejt me lëvizjet e tjera çlirimtare kombëtare në të gjithë botën dhe legjitimiteti i së cilës është i bazuar në precedentët e vendosur nga republikat tjera të ish-Jugosllavisë shkëputja e të cilave u legjitimua nga Komisioni i Badinterit. Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë e njohu rregullsinë e një legjitimiteti të tillë, duke hapur rrugën që Kosova të konsiderohet si një anëtar i ligjshëm i komunitetit ndërkombëtar.²²

Kosova tashmë i është bashkuar procesit të integritetit në BE, duke hapur kështu negociatat për procesin e liberalizimit të vizave pas fillimit të Marrëdhënieve me Serbinë në negociatat e drejtuara nga BE dhe zyrtari kryesor i saj për politikën e jashtme, ish-Përfaqësuesi i Lartë të Bashkimit për Punët e Jashtme dhe Politikën e Jashtme, Baronesha Ashton. Të njëjtat bisedime ndihmuan edhe Serbinë për të marrë së pari statusin e kandidatit në mars 2012, dhe dy vjet më vonë, në janar 2014 hapjen me sukses kapitujve të bisedimeve për anëtarësim të plotë në BE. Kosova është pas Shqipërisë në shpejtësinë e saj të integritetit, dhe një asimetri e tillë mund të çojë në fërkime të mundshëm në të tashmen dhe të ardhmen në lidhje me qarkullimin e lirë të

²² Shih për një këndvështrim më të detajuar mbi këtë Kalemaj 2013.

mallrave, shërbimeve, punës dhe kapitalit, si dhe kufizimeve ndaj mallrave të tilla dhe lirisë së lëvizjes nga vendet e treta.

3.3 Gjetjet nga fokus grupi

Për të krijuar një tablo më të nuancuar dhe pasur pikëpamje të ndryshme në lidhje me gjendjen aktuale të Marrëdhënieve në mes të Shqipërisë dhe Kosovës, si dhe të projeksioneve afatshkurtra dhe afatmesme, kemi organizuar një fokus grup me pjesëmarrjen e gazetarëve, akademikëve, diplomatëve, ekonomistëve dhe specialistëve të kulturës. Ata dhanë mendimet e tyre të mirë informuara në lidhje me marrëdhëniet e tanishme dhe të ardhshme ekonomike, kulturore, sociale dhe politike mes dy shteteve.

Florjan Salaj për shembull, duke diskutuar nga një pikëpamja e ekonomistit shprehu mendimin se aktiviteti tregtar mes të Shqipërisë dhe Kosovës nuk ka qenë konsekuent. Por ai shtoi se "që nga 2008 deri aktualisht qasja e qeverisë ka qenë konsekuente". Gjithashtu ai beson se është duke u krijuar një treg i unifikuar kulturor, se martesat mes qytetarëve të dy vendeve po shtohen, etj. Mendim të njëjtë, në lidhje me bashkimin e tregut kulturor, me libra, revista, gazeta dhe televizione të cilat lexohen dhe shihen në të njëjtën kohë në të dy anët e kufirit, ndanë edhe kritiku letrar Behar Gjoka dhe ekonomisti Gjergj Erebara.

Profesorja e studimeve europiane Mirela Bogdani nga ana tjetër shprehu bindjen e saj të fortë se çdo lloj bashkimi i mundshëm midis dy vendeve do të ishte e pamundur. Dhe kjo jo vetëm për shkak së aktorët ndërkombëtarë e kundërshtojnë këtë gjë, por edhe për faktin mjaft të rëndësishëm të dallimeve në mes të dy vendeve, të cilat kanë pasur trajektore historike të ndryshme. Gjithashtu për Bogdanin, elementi fetar i cili është i rëndësishëm për shqiptarët e

Kosovës është në kundërshtim me laicitetin e vëllezërve të tyre në Shqipëri. Dorian Koçi, vuri në pah klauzolën penguese të Planit Ahtissari, që më vonë u reflektua edhe në Kushtetutën e Kosovës, e cila shprehimisht ndalon një bashkim të mundshëm në mes të Kosovës dhe Shqipërisë.

Ish-ambasadori i Shqipërisë në Gjermani dhe një diplomat me përvojë Tomorr Alizoti vë theksin tek mungesa e një strategjie koherente nga ana e politikës së jashtme të Shqipërisë, dhe kjo bërë që përfaqësuesi i OKB të flasë për "pavarësi të kufizuar" të Kosovës në deklaratat e tij të vitit 2004. Më vonë Shqipëria është përpjekur të mbajë një rol të moderuar që ka qenë konform qëndrimit të faktorit ndërkombëtar.

E njëjta pikëpamje, e mungesës nga Shqipëria të strategjisë afatgjatë në drejtim të Kosovës, por në të njëjtën kohë edhe të mungesës së strategjisë nga Kosova gjithashtu, u nda edhe nga diplomati tjetër në takim Elvina Isufaj, e cila aktualisht është Drejtor Ekzekutiv i Këshillit të Marrëdhënieve me Jashtë të Shqipërisë. Ajo vijoi duke theksuar se "mungesa e strategjisë ishte një nga faktorët që ka pasur ndikim negativ kur në 2005 Shqipëria kërkoi të njëjtën pavarësi të kufizuar për Kosovën, e cila ishte diçka absurde për faktin që vinte nga Shqipëria".

Ndërsa Dr. Fabian Zhilla, në diskutimin e tij vuri në dukje mungesën e politikave të përbashkëta në arsim dhe fusha të tjera të rëndësishme, çka e bën të vështirë realizimin e çdo thellimi të mundshëm të bashkëpunimit mes dy vendeve. Paradoksisht, nga ana tjetër ai vëren gjithashtu një zell nacionalist në rritje në të dy anët e kufirit. Geron Kamberi, një zyrtar i politikave në QuoDev Shqipëri vëren një strategji të suksesshme në infrastrukturë, dhe jo vetëm në aspektin e rrugëve siç është projekti i Rrugës së Kombit, por edhe në infrastrukturën energjetike, etj. Gazetari Lavdrim Lita e sheh perceptimin nga poshtë lart si shumë të rëndësishëm, ndonëse jo të ilustruar mjaftueshëm në tekste.

Ai vë në dukje gjithashtu dobësinë e shtetit shqiptar dhe faktin se më shumë se vetë shqiptarët, janë të huajt ata që janë marrë më shumë në procesin e bashkimit të shqiptarëve. Megjithë këtë, Kosova dhe Shqipëria kanë dërguar trupa ushtarake të përbashkëta në Afganistan, etj, çka është një sinjal se ka një bashkëpunim në rritje midis dy shteteve edhe në sferën ushtarake, të sigurisë dhe punëve të jashtme, pavarësisht nga fakti se në Strategjinë e Sigurisë Kombëtare të Shqipërisë, të miratuar rishtaz, Kosova figuron e përmendur vetëm në një rresht të vetëm.

Ekonomisti Zef Preçi e kundërshton këtë pikëpamje me faktin se edhe në strategjinë Kosova 2020 Shqipëria figuron po ashtu periferike. Por ai fajëson kryesisht për këtë klasën politike të Shqipërisë për mungesë vizioni në lidhje me Kosovën, e cila nga ana tjetër e bën "Jugosferën" si të vetmen marrëveshje të mundshme gjeopolitike. Kjo e fundit natyrisht përjashton Shqipërinë. Ai gjithashtu vuri në dukje problemin e inferioritetit që elitat në Tiranë e Prishtinë kanë dhe kompleksin që ata tregojnë përkundrejt të huajve, dhe kjo manifestohet ndër të tjera në Tiranë ku në vend që në terminologjinë zyrtare të përdoret 'Kosova' përdoret termi 'Kosovo'. Ai gjithashtu vuri në dukje fshehtësinë e Tiranës në lidhje me zbulimin e axhendës së saj diplomatike në lidhje me Kosovën në veçanti dhe të rajonit në përgjithësi, dhe përmend axhendën vizitës së Kryeministrit Rama në Beograd e të cila ishte mbajtur në mister.

Në anën tjetër, gazetari dhe moderator televiziv Artur Nura vuri në dukje se "konflikti i brendshëm mund të transformohet lehtë në politikën e jashtme". Për të, një bashkim *de facto* i Shqipërisë dhe Kosovës ka ndodhur tashmë, duke përmendur si shembull kompaninë Digitalb e cila bën të mundur që kanalet televizive të Tiranës të shihen edhe në Kosovë. Edhe pse zoti Nura nënvizon këtë, ai nuk shpjegon mungesën e përfaqësimit të stacioneve radio televizive të

Kosovës në Shqipëri. Për më tepër në Shqipëri mungon edhe prezenca e medimeve të tjera nga Kosova si gazetatat, revistat dhe në një masë më të vogël edhe librat.

Gazetari Gjergj Zefi i kujtoi të pranishmit e tjerë për faktin se lufta në Kosovë u fitua nga shqiptarët vetëm përmes ndërhyrjes së NATO. Por nga ana tjetër ai tha: "[n]ë BE ne nuk do të bashkohemi vetëm me Kosovën por edhe Serbinë". Ai gjithashtu deshi të theksohej fakti se "paraja nuk ka ngjyrë" dhe se ekonomia i sjell njerëzit dhe kulturën së bashku, edhe në një rajon të paqëndrueshëm dhe të ndjeshëm politikisht siç është Ballkani Perëndimor. Mirela Bogdani shtoi këtu se procesi i vetëm integritetit nuk është ai mes Shqipërisë dhe Kosovës por ai i drejtuar drejt integritetit në BE, ku Kosova dhe Shqipëria mund të bashkohen, pavarësisht ndarjeve të tyre kulturore. Gjithashtu ajo vuri në dukje se "Kosova është ende nën tutelën ndërkombëtare dhe se feja është më shumë përçarëse në Kosovë sesa në Shqipëri, si dhe më me influencë", por këto ndarje mund të tejkalohen pas integritetit në Bashkimin Evropian të të dy vendeve.

KAPITULLI IV

Analiza e Marrëdhënieve Afatshkurtra, Afatmesme dhe Afatgjata Ndërmjet Shqipërisë dhe Kosovës

Skenarët Potencialë

Skenari A

Në këtë skenar, Kosova dhe kufijtë e Shqipërisë gradualisht do të bëheshin të parëndësishëm, si pjesë e Bashkimit Evropian nëse në atë fazë të dy vendet do të jenë integruara. Periudha e mundshme kur kjo mund të ndodhë, ne supozojmë të jetë jo më parë se viti 2030. Për Shqipërinë

perspektiva e anëtarësimit, nëse do të ndërmerren reformat e duhura dhe ligjet do të zbatohen siç duhet, duke përbërë kështu sundimit e plotë të ligjit, mund të jetë në vitet 2022-2023. Në rastin e Kosovës, anëtarësimi i plotë nuk mund të ndodhë para 2030 edhe në rastin më të mirë.

Në Shqipëri, sfidat kryesore dhe 'detyrat e shtëpisë' janë krijimi i mekanizmave anti-korrupsion, për të luftuar krimin e organizuar dhe pastrimin e parave, një administratë publike tërësisht funksionale të bazuar tek meritokracia dhe të çliruar nga militantët partiakë, të drejtat pronësore dhe reformimi i sistemit të drejtësisë e cila perceptuar gjerësisht si jofunksionale, politikisht i njëanshme dhe e korruptuar. Në Kosovë, sfidat janë edhe më të mëdha. Jo vetëm që Kosova vuan nga shumica e simptomave të lartpërmendura, por përveç kësaj ajo nuk është njohur nga të gjitha vendet anëtare të BE, pasi pesë vende (Greqi, Qipro, Spanja, Sllovakia dhe Rumania) deri më tani kanë refuzuar ta njohin. Gjithashtu, Kosova nuk posedon tërësisht elementet e sovranitetit të brendshëm, ku Mitrovica e Veriut është jashtë kontrollit efektiv të qeverisë së Prishtinës dhe strukturat si UNMIK, KFOR dhe EULEX vazhdojnë të kufizojnë prerogativat e plota të një shteti të Kosovës. Për më tepër, Kosova përballet me një shkallë të lartë të rrezikut nga fundamentalizmi islamik. Sipas profesorit të filozofisë Blerim Latifi dhe sociologut Ismail Hasani, kriza politike dhe e zhvillimit së bashku me cilësinë e dobët të sistemit arsimor krijojnë një habitat për rritjen e Islamit politik dhe rrezikimin e perspektivës së rinjve Kosovarë.²³

Nga një këndvështrim tjetër, qeveria e Thaçit dhe spektri kryesor politik po i rezistojnë mirë presioneve nacionaliste, sipas raportit të 2014 të Economist Intelligence Unit.²⁴ Krahës kësaj, marrëdhëniet mes Shqipërisë dhe Kosovës janë duke u bërë më të forta, edhe pse autoritetet në të dyja vendet janë distancuar nga nacionalistët të cilët bëjnë thirrje për një "Shqipëri të Madhe".

²³ <http://www.gazetatema.net/web/2014/08/13/latifi-mungesa-e-cilesise-ne-arsim-nje-nga-arsyet-e-radikalizmit-islamik/>

²⁴ <http://country.eiu.com/albania>

Gjithashtu raporti vë në dukje se qeveria socialiste në Tiranë shihet si me ngurruese ndaj thirrjeve nacionaliste se sa paraardhësja e saj.²⁵

Megjithatë në perspektivën afatgjatë, skenari i lartpërmendur është më i mundshmi, pasi angazhimi i BE në "oborrin e saj të pasmë" të Ballkanit Perëndimor është të mos lërë vrima të zeza prapa. Ky angazhim i BE ekziston pavarësisht qasjes së politikës afatshkurtër, të përqafuar edhe nga vende të suksesshme të rajonit të cilat kanë preferuar "parimin e garës", si Kroacia e cila u anëtarësua në BE vitin e kaluar. Ky parim kërkon që çdo vend të përparojë drejt integritit me hapin e vet, duke zëvendësuar kështu "parimin e karvanit" i cili pranon konceptin e anëtarësimit në bllok, dhe duke i detyruar kështu shtetet më të suksesshme të jetë në të njëjtin nivel me ato të mbetura prapa (Gogova & Radoslavova 2001).

Skenari B

Në këtë skenar tjetër, Shqipëria dhe Kosova janë pjesë e njërit nga forumet e mëposhtme rajonale: Bashkimi Ballkanik, Beneluksi Ballkanik, CEFTA, etj, por vetëm një prej tyre, me më shumë gjasa Shqipëria, është bërë pjesë e BE në dhjetë vitet e ardhshme apo më shumë. Kjo është ajo çka në të vërtetë po ndodh dhe statusi i kandidatit të Shqipërisë që është duke pritur për të hapur kapitujt e bisedimeve për anëtarësim të plotë është premtues. Duke parë tendencat aktuale dhe zhvillimet e mundshme ky duket si skenari më realist. Trajektore të tilla do ti bënin Marrëdhëniet mes dy vendeve asimetrike në periudhën afatshkurtër dhe potencialisht afatmesme, duke parë shtimin e fërkimeve të mundshme apo ankesave dhe presioneve nga grupet e ndryshme të interesit nga të dyja palët.

Mungesa aktuale e vullnetit politik si dhe e vizionit dhe lidërshiptit reflektohen gjithashtu në asimetrinë ekonomik. Siç vuri në dukje ish-Ministri i Financave Arben Malaj, në një takim të

²⁵ Po aty

organizuar së fundi në Tiranë nga AIIS mbi Marrëdhëniet Tregtare midis Shqipërisë dhe Kosovës, "ne na mungojnë institucionet e përbashkëta. Gjithashtu ne kemi nevojë për përmirësimin e sistemit të monitorimit në mënyrë që të përmirësojmë efikasitetin". Por kjo sipas Malajt nuk duhet të bëhet nga qeveritë por nga ekspertët. Gjergj Buxhuku i Konfindustrisë shprehu pikëpamjen se "për sa kohë që do të ekzistojë kufiri, do të vazhdojnë dhe mosmarrëveshjet", duke avancuar kështu idenë për një ndryshim të kufirit në mënyrë të njëanshme, çka nuk gjeti konsensusin e pjesëmarrësve të tjerë. Me të drejtë, ekonomisti Selami Xhepa vuri në dukje se infrastruktura i bën kufijtë të padukshëm dhe mundëson rritjen e niveleve të tregtisë.

Ai mori shembullin e autostradës së Kosovës që shpuri në rritjen e vëllimit të tregtisë në 23 për qind, nga 4 për qind që ishte para ndërtimit të saj, dhe këmbënguli se interneti në të dy anët e kufirit duhet të përdoret më shumë për biznesin dhe më pak për qëllime rekreative. Për arsye se Gadishulli i Ballkanit ka pak ngjashmëri me gadishuj të tjerë evropianë, siç vërejti me të drejtë Geron Kamberi në të njëjtin takim, ne priremi për të prodhuar pak a shumë të njëjtat produkte dhe kemi tregje të copëzuara, çka i bën Shqipërinë dhe Kosovën më pak konkurruese në tregjet ndërkombëtare. Duket se e vetmja zgjidhje është një bashkim i mundshëm, i cili për shumicën e vëzhguesve duhet që *de facto* të vijë vetëm pas integritit e të dy vendeve në Bashkimin Evropian.

Niveli i tregtisë reflektohet edhe në numrin e bizneseve të të dy shteteve në territorin e tjetrit. Ka vetëm 380 biznese kosovare në Shqipëri, disa prej të cilave janë me kapital të përzier dhe pak më shumë se 500 kompani shqiptare në Kosovë, çka është një dëshmi e veprimit të tregut me potencialin e tij të plotë. Edhe pse situata duket e zyrtë, duket se iniciativa të reja janë ndërmarrë nga të dy qeveritë Rama dhe Thaçi për të rritur volumin e tregtisë dhe thelluar

partneritetin tashmë miqësor. Iniciativa të tilla shkojnë që nga çështjet e energjisë tek lehtësirat për punëtorët nga vendet përkatëse për të punuar lirisht dhe paguar detyrimet e sigurimeve shoqërore në secilin vend, të cilat do të shkojnë më vonë tek skema e tyre përkatëse e pensioneve, edhe pse këto iniciativa të reja politikash do të duhet ende kohë që do të zbatohen në mënyrë që të shkojnë nga fjalët tek veprat. Fushë tjetër e bashkëpunimit të ngushtë është ajo policore ku është arritur një marrëveshje që gjatë verës, kur sezoni i pushimeve arrin kulmin, patrullat e Kosovës të mund të operojnë brenda territorit të Shqipërisë dhe anasjelltas. Fusha të tjera përfshijnë unifikimin e teksteve shkollore, një prioritet për të dy vendet, unifikimin e programeve mësimore, etj.

Edhe në ato organizata rajonale ku Kosovës i është dërguar ftesë, kjo është bërë e shoqëruar me yll dhe jo me një fusnotë siç ishte sugjeruar më parë. Ky është një hap përpara, por Kosova ende nuk lejohet të përdorë simbolet saj shtetërore, përfshirë flamurin shtetëror, dhe zyrtarët serbë kërkojnë praninë e UNMIK në takime (Jovanović dhe Karadaku 2012). Nuk është e sigurt se si do të jetë situata këtej e tutje meqenëse Kosova kohët e fundit ka parashtruar një kërkesë formale që misioni i UNMIK të tërhiqet.

Skenari C

Shqipëria dhe Kosova realizojnë bashkimin *de facto* përpara aderimit në BE. Ky është një skenar mjaft i pamundur, ndonëse është pohuar me gëzim nga nacionalistët në të dy anët e kufirit. Ndër mbështetësit e mendimit të tillë janë rrymat e partive politike kryesore si Vetëvendosja në Kosovë (parti e majtë nacionaliste) apo PDIU në Shqipëri (parti nacionaliste e qendrës së djathtë) apo partitë në kufijtë e spektrit politik si Lista Natyrore dhe Aleanca Kuq e Zi

në Shqipëri dhe Partia e Drejtësisë në Kosovë (e cila ishte pjesë e koalicionit para-zgjedhjeve dhe që ende është në qeverinë në vazhdim), etj. Lidhur me Vetëvendosjen, siç e ka vënë në dukje një analist nga Shqipëria kohët e fundit në një intervistë për të përditshmen Zëri në Kosovë: "për të qenë të drejtë, ata [Vetëvendosja] kanë propozuar një gjë, idenë e vjetër të bashkimit kombëtar si një metaforë e një ilaçi për të zgjidhur të gjitha të këqijat shqiptare". Ilaçi që shëron çdo gjë është bashkimi kombëtar nën një flamur, sipas Albinit "(Lita 2014).

Edhe pse Lita vazhdon duke argumentuar se Albin Kurti deri tani nuk ka gjetur një aleat për projektin e tij politik në Kosovë ose në Shqipëri, në fakt shembujt më lart, si ai i PDIU, një parti në parlament, dhe AK në Shqipëri, apo disa parti të vogla në skajet e jetës politike në Kosovë, dëshmojnë për të kundërtën.

Por përkrahës të kësaj pikëpamje nuk janë vetëm partitë politike. Të dhënat e paraqitura më lartë nga sondazhet dhe anketat e fundit tregojnë gjithashtu për një mbështetje çuditërisht të lartë për bashkimin mes dy vendeve, edhe pse janë më të pakët ata që e vlerësojnë si realiste këtë gjë. Një kategori tjetër e rëndësishme janë intelektualët nacionalistë të cilët kanë kërkuar vazhdimisht për një bashkim të shpejtë dhe të suksesshëm "të dy pjesëve të të njëjtit trung". Të tillë intelektualë të shquara përfshijnë në radhët e tyre Rexhep Qosen apo Adem Demaçin, ndër shqiptarët e Kosovës, dhe një numër intelektualësh dhe shkrimtarësh të shquar nga Shqipëria.

Skenari D

Shqipëria dhe Kosova të operojnë si dy shtete funksionale pa bashkimin e projektuar të çfarëdo lloji, ku Shqipëria i bashkohet BE, ndërsa Kosova vijon ende me procesin e përfundimit të ndërtimit të shtetit. Kjo është perspektiva për 10-15 vitet e ardhshme sipas mendimit tim. Unë

pres që Shqipëria të përmbushë procesin e integrimit dhe më në fund ti bashkohet Bashkimit Evropian rreth viteve 2022-2023, ndërsa për Kosovën kjo perspektivë mund të shkojnë deri në vitet 2035-2040, përveç nëse ndodh ndonjë ndryshim i planeve dhe rajoni integrohet në bllok.

Ky skenar duket se po ndodh ndërsa shkruajmë, pasi Shqipëria tashmë ka marrë statusin e kandidatit dhe është duke pritur për të hapur kapitujt e bisedimeve për anëtarësimin e plotë në çdo kohë. Periudha e saktë nuk është vendosur ende, por Shqipëria e ka marrë tashmë një listë të "detyrave të shtëpisë" që duhet të përfundojë, të cilat përfshijnë reformat për të luftuar krimin e organizuar dhe korrupsionin, de-politizimin e administratës publike, reformën në sistemin ligjor, gjetjen e një zgjidhje afatgjatë për të drejtat e pronësisë, dhe konsensusin politik që më në fund do të stabilizojë vendin dhe ta bëjë atë më të prirur drejt demokratizimit.

Megjithatë, siç u bë e qartë kohët e fundit në Samitin e Berlinit, ku liderët e Ballkanit Perëndimor morën pjesë, nuk do të ketë anëtarësime të mëtejshme në rajon për pesë vitet e ardhshme. Me fjalë të tjera, asnjë nga vendet kandidate (Serbia, Shqipëria, Mali i Zi dhe Maqedonia) apo Kosova dhe Bosnjë-Hercegovina nuk mund të presin që ti bashkohen Bashkimit Evropian të paktën deri në vitin 2019. Kjo është periudha e arsyeshme por për shkak të çështjeve të njohjes ose shtet-ndërtimit dhe problemeve të tjera funksionale, vende si Kosova dhe Bosnje-Hercegovina do të duhet praktikisht të presin akoma edhe një dekadë tjetër mbasi katër vendet e tjera mundësisht të janë anëtarësuar.

Konkluzion

Çështja e shpërbërjes së kufijve pasi Kosova dhe Shqipëria më në fund do të integrohen në Bashkimin Evropian, merr një automaticitet të qartë i cili nuk merr parasysh pengesat e

ndryshme të këtij procesi. Albin Kurti, lideri karizmatik i Vetëvendosjes e ka shpesh përsëritur se anëtarësimi në Bashkimin Evropian nuk do ti shpërbëjë kufijtë por do ti forcojë ato. Me fjalë të tjera ai nënkupton se shqiptarët e Kosovës dhe Shqipërisë duhet të kërkojnë bashkimin përpara dhe jo pas antarësimit në BE.

Për sa i përket faktorëve objektivë - të cilët mund ti krijojnë një pengesë një faktori lehtësues drejt bashkimit të mundshëm midis dy vendeve, para ose pas hyrjes në BE, e cila me siguri që do të bazohet në meritat individuale dhe reformat strukturore - mund të rreshtojmë disa faktorë të rëndësishëm. Njëri është madhësia ekonomike, Shqipëri ka një ekonomi pak më shumë se dy herë më e madhe (me 9.6 miliardë euro) se sa ajo e Kosovës prej 4.5 miliardë Euro. Edhe pse kjo afërsisht i korrespondon numrit të popullsisë që është pothuajse dyfish më i madh në Shqipëri, apo territorit që është pothuajse tre herë më i madh në Shqipëri sesa në Kosovë, përsëri asimetritë mund të kthehet lehtësisht në frikëra që pengojnë integrimin e mëtejshëm ndërmjet tyre. Por nga ana tjetër, ato mund të kthehen në mundësi në qoftë se liderët e të dy vendeve kuptojnë se edhe bashkimi i dy shteteve përsëri do të përbënte një hap të vogël në krijimin e kërkesës së duhur të konsumit dhe tërheqjen e investimeve të mjaftueshme të huaja direkte për shkak se krahasimisht madhësia e tregut përsëri mbetet e vogël. Por përsëri, një rast i tillë do të ishte më tërheqës se ai aktual dhe ndoshta do jetë një nxitje për lëvizur gjërat përpara, duke synuar të paktën integrimin e tregjeve financiare dhe gjetjen e zgjidhjeve që mund të kulmojnë në një bashkim doganor apo arritur madje fazën e integritit të plotë ekonomik.

Ne e hapëm këtë studim me ngjarjet që ndodhën në stadiumin e Beogradit ku u dëgjuan me zë të lartë kore anti-shqiptare nga tifozët serbë dhe një dron që mbante flamurin e Shqipërisë së Madhe fluturoi në mënyrë provokuese në stadium. Vizita e kryeministrit Rama në Beograd, historike për natyrën e saj u shty me tre javë, si rezultat, dhe u arrit që të realizohet vetëm pas

ndërhyrjes së Kancelares Merkel dhe partnerëve të tjerë ndërkombëtarë. Por sa e justifikuar është frika e "Shqipërisë së Madhe", e cila në thelb presupozon bashkimin e Kosovës me Shqipërinë? Florian Bieber në një artikull të kohëve të fundit për Sudeosteuropa shkruan ndër të tjera: "[i]deja e "Serbisë së Madhe" dhe e "Shqipërisë Natyrale", (siç shpesh e quajnë atë ithtarët e saj) ekzistojnë. Megjithatë këto janë ide të parëndësishme. Aleanca Kuq e Zi në Shqipëri mori vetëm pak më shumë se 10.000 vota në zgjedhjet parlamentare në vitin 2013, partia e vetme që e mbështet hapur këtë axhendë" (Bieber 2014). Kjo ka qenë e vërtetë për të gjithë periudhën post-komuniste dhe thjesht nuk ka pasur asnjë trashëgimi nga e kaluara për një të ashtuquajturën Shqipëri të Madhe, kështu që këto frika thjesht nuk janë të justifikuara dhe të mbështetura empirikisht.

Krejt në të kundërt, unë besoj se çdo projeksion për një bashkim *de jure* përpara aderimit të plotë të dy vendeve (Shqipërisë dhe Kosovës) në Bashkimin Evropian, i cili mund të marrë dekada, thjesht nuk është realist dhe është i pamundur për tu materializuar, dhe kjo jo vetëm për shkak të pengesave kushtetuese dhe kundërshtimit të aktorëve ndërkombëtarë, por edhe për shkak të rezistencës nga udhëheqësit politikë kryesorë në të dy vendet të cilët mund ta shohin ndonjë bashkim të mundshëm si kërcënim për pushtetin e tyre personal. Ndërsa, bashkimi *de facto* në anën tjetër, i cili mund të kulmojë ose me krijimin e një zone të lirë të tregut, një bashkim doganor ose në një zone ekonomike të integruar plotësisht, përpara ose pas anëtarësimit të plotë në BE, mund të realizohet në një farë mase dhe me sukses të caktuar, në varësi të vullnetit politik dhe rrethanave gjeopolitike. Megjithatë, ky mund të jetë një bashkim vetëm midis Shqipërisë dhe Kosovës, ose përndryshe mund të jetë në formën e një organizate rajonale, siç është ideja e Beneluksit Ballkanik, e cila në një skenar të projektuar përfshin edhe Maqedoninë dhe Malin e Zi.

Në tërësi, në këtë studim kemi analizuar skenarët e projektuar të bashkëpunimit mes Shqipërisë dhe Kosovës, se si ky bashkëpunim ka evoluar që nga shpallja e pavarësisë së Kosovës, si është tani dhe cilat janë shanset për skenarët e mundshëm në terma afatshkurtër dhe afatmesëm. Sigurisht, unë kam marrë shkurtimisht në konsideratë historinë, kulturën, dhe gjithashtu historinë politike të së shkuarës në marrëdhëniet mes Shqipërisë dhe Kosovës, për të nxjerrë konkluzione të rëndësishme dhe të mbështetura për të ardhmen e afërt.

Pretendimi im është se rruga e integritit evropian është paksa e ndryshme për të dy vendet, ku Shqipëria ka më shumë shanse për t'u anëtarësuar në BE përpara Kosovës dhe kjo do të kushtëzojë më tej qëndrimin e Shqipërisë ndaj Kosovës në fushat e bashkëpunimit ekonomik, social, kulturor, dhe politik. Dëshira përfundimtare për një bashkim të mundshëm të dy gjysmave sipas modelit gjerman pas rënies së Perdes së Hekurt, i cili ka qenë qëllimi përfundimtar i aktorëve dhe faktorë nacionaliste në të dy anët e kufijve, është i vështirë për t'u imagjinuar dhe konkretizuar jashtë kuadrit të anëtarësimit evropian të të dy vendeve, kur kufijtë do të bëhen të parëndësishme dhe arrihet një integrim i plotë ekonomik.

Referencat

- Bieber, Florian. 2014. "Greater Serbia and Greater Albania do not exist: The myth of bad Serb-Albanian relations". *Balkans in Europe Policy Blog*. Gjetur në 8 Nënto 2014 tek: <http://www.suedosteuropa.uni-graz.at/biepag/node/113>
- Coakley, J., ed. 1992. *The Social Origins of Nationalist Movements: The Contemporary West European Experience*. London: SAGE Publications.
- Gogova, Ivana & Branimira Radoslavova. 2001. "Croatia on the Road to EU Membership," *Central Europe Review*, 3 (14).
- Ivanovic, Jovana & Linda Karadaku. "Serbia to participate with Kosovo at regional gatherings." *Southeast European Times*. 10/09/12. http://www.setimes.com/cocoon/setimes/xhtml/en_GB/features/setimes/features/2012/09/10/feature-01
- Kalemaj, Ilir. 2013. The Typologies of International Recognition (Kosovo as a *sui generis* case). [Tipologjitë e njohjes ndërkombëtare (Kosova si një rast *sui generis*)]. *Studime Juridike*, botim i Fakultetit Juridik, Universiteti i Tiranës.
- Kalemaj, Ilir. 2014. *Contested Borders: Territorialization of National Identity and Shifts of "Imagined Geographies" in Albania*. Peter Lang Ltd. Oxford 2014.
- Krasniqi, Afrim. 2014. Raporte Elitare vs Raporte Militante mes Shqiptareve. Shqiptarja daily. 14.08. Shiko artikullin e plotë: <http://www.shqiptarja.com/analiza/2709/raporte-elitare-vs-raporte-militante-mes-shqiptareve-239173.html>
- Lita, Lavdrim. 2014. "Martesa i beri mire Albin Kurtit, e normalizoi" *Zëri* newspaper. 12 September.
- Lynggaard, Kennet. 2012. "Discursive Institutional Analytical Strategies." *Research Design in European Studies: Establishing Causality in Europeanization*, (4)15.
- Maliqi, Shkelzen. 2014. "Shkëlzen Maliqi këshilltar i kryeministrit Edi Rama për rajonin, shprehet se tendenca e një kombi kosovar është tendencë absurde." *Gazeta Mapo*, 23 Gusht. Tirane.
- Pedrazzi, Nicola. 2014. "A Pope in a symbolic land: Albania." *Osservatorio Balcani e Caucaso*. Shiko në: [http://www.balcanicaucaso.org/eng/Regions-and-countries/Albania/A-Pope-in-a-symbolic-land-Albania-155747/\(from\)/eng-newsletter](http://www.balcanicaucaso.org/eng/Regions-and-countries/Albania/A-Pope-in-a-symbolic-land-Albania-155747/(from)/eng-newsletter)
- Spahiu, Nexhmedin. 2014. "Kombi Kosovar është definuar para 20 viteve, atë nuk mund ta definojë Shkelzen Maliqi sot". *Bota Shqiptare*, 25 Gusht. Shiko në: <http://www.botapress.info/index.php/opinione/item/10695-shkelzen-maliqi-sot-nj%C3%ABsoj-si-boris-tadiqi-dje>

- Zheji, Artur. Do ta provojne edhe gjermanet. Gazeta Mapo. 23.08.1014. Shiko artikullin e plotë në: <http://mapo.al/2014/08/ta-provojne-edhe-gjermanet/>

- **Faqe interneti**

- <http://botasot.info/lajme/339598/ambasadorja-e-shba-ne-kosove-u-drejtohet-shqip-politikaneve-mos-e-dhini-punen-video/>
- <http://country.eiu.com/albania>
- <http://www.alsat-m.tv/index.php/lajme/rajoni/116664.html>
- http://www.balkan-monitor.eu/files/Gallup_Balkan_Monitor-Focus_On_Kosovo_Independence.pdf
- <http://www.gazetaexpress.com/lajme/panariti-ska-barriera-per-miellin-kosovar-qe-ploteson-standardet-48693/>
- <http://www.gazetatema.net/web/2014/05/07/hiqen-lejet-e-punes-per-qytetaret-e-kosoves-dhe-lugines-se-presheves/>
- <http://www.gazetatema.net/web/2014/08/13/latifi-mungesa-e-cilesise-ne-arsim-nje-nga-arsyet-e-radikalizmit-islamik/>
- <http://www.kosovocompromise.com/cms/item/topic/en.html?view=story&id=1571>
- <http://www.lajmeonline.net/en/commercial-returns-kosovo-war-shqiperi/>